


	University of Prizren Universiteti Prizrenë "UKSHIN HOTI"
Pranuar me d.t.	05.11.2019
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-443



MARRËVESHJE

Ndërmjet
Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

dhe
„Loyola – Gymnasium” Prizren

Duke u bazuar në interesin e përbashkët në zhvillimin dhe avancimin e mësimdhënies - mësimnxënies në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren dhe në Gjimnazin "Loyola-Gymnasium" në Prizren, por edhe zgjerimin e bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy institucioneve:

Gjimnazi "Loyola-Gymnasium" Prizren, që ka rezidencën e tij ligjore në Prizren; Adresa: Asociation Loyola Gymnasium; Rruga e Transitit pn. Petrovë; 20000 Prizren – Kosovë, përfaqësuar nga drejtori Neki Jahaj.

Gjimnazi "Loyola-Gymnasium" i cili ka kompetencë për të marrë pjesë në shërbimet publike në fushën e arsimit të ulët dhe mesëm të lartë si dhe krijimin e marrëdhënieve me institucionet e tjera akademike, kulturore dhe shkencore në Kosovë dhe jashtë saj;

dhe

Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, Adresa: "Rruga e Shkronjave" nr. 1; 20000 Prizren; Kosovë, i përfaqësuar nga Rektori - Prof. asoc. dr. Ismet Temaj. UPZ është universitet publik i themeluar më 2009 nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe me Statut të miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës me vendimin nr. 04 -V-621.

dakordohen
për të nënshkruar një Marrëveshje të bashkëpunimit të bazuar në pikat si në vijim:

Bashkëpunimi do të realizohet duke pasur si subjekt miratimin e Universitetit dhe Gjimnazit për:

- Hospitimin (një favorë – 10 orë mësimore) të studentëve të vitit të katërt të degës Gjuhë dhe Letërsi Gjermane.
 - Studentët duhet të paraqiten në Loyola-Gymnasium me një CV dhe letër motivuese, si dhe t'i nënshtronen një interviste me udhëheqësin/udhëheqësen e degës së gjermanishtes.

- b) Studentët e pranuar duhet të marrin pjesë në të gjitha orët e parapara.
- II. Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje ndërmjet Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren dhe Gjimnazit “Loyola – Gymnasium” nuk nënkupton asnjë detyrim financiar.
- III. Kjo marrëveshje qëndron në fuqi për një periudhë 1 (një) vjeçare nga data e nënshkrimit. Pas përfundimit të datës kjo marrëveshje mund të vazhdohet bazuar në një marrëveshje të përbashkët me shkrim apo edhe të ndërpritet.
- IV. Kjo marrëveshje mund të prishet edhe para skadimit të afatit, nëse njëra palë nuk i plotëson kërkesat e marrëveshjes.
- V. Kjo marrëveshje gjen zbatim me nënshkrimin nga përfaqësuesit kompetent ligjorë të të dy institucioneve.
- VI. Kjo marrëveshje është hartuar në dy (2) ekzemplarë në gjuhën shqipe.

Prizren, më: 28.10.2019

